



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-2588/1 nga 22.03.2022, e formuarë pas kërkesës së dorëzuar për kryerje të revizionit në ----- filiali -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent, ndërsa denoncimi të paraqitet për veprim kompetent në Entin Shtetëror të Revizionit.

Lënda me numër 12-2588/1 nga 22.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më 22.03.2022 është dorëzuar denoncim me të cilën kërkohet kryerje të revizionit në ----- filialin ----- dhe u formua lënda me numër 12-2588/1 nga 22.03.2022.

Parashtruesi kërkon që KSHPK-ja të kryejë një kontroll revizioni, në filialin në fjalë, mundësisht nga viti 1997 deri në vitin 2022, i cili do të kontrollojë punën e drejtuesve dhe udhëheqësve në lidhje me abuzimet e kryera dhe projektet e papërfunduara.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se raporti nuk përmban pretendime për veprime të paligjshme dhe keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar nga zyrtarët, si dhe se KSHPK-ja nuk ka kompetencë ligjore për të kryer një revizion të veprimtarisë së përgjithshme të subjektit të treguar, sipas të cilit ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe lëndën do ta dërgojë për veprim kompetent në Entin Shtetëror të Revizionit.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit

Pērgatiti: B.K.SH
Miratōi: G.T., Anētar i KSHPK-sē

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР ПΑΑΑΝΔΑΛΙΜΙΝ Ε ΚΟΡΡУРСΙΟΝИТ**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

